



BULETIN MUJOR

GUSHT 2025



PËRMBAJTJA

- Në prag të garës evropiane të sigurisë kibernetike ECSC 2025/ Vijon përzgjedhja e ekipit shqiptar
- AKSK prezanton mekanizmin e ri të raportimit javor për infrastrukturën kritike dhe të rëndësishme të informacionit
- Maratona Kombëtare e Sigurisë Kibernetike: Sfida dhe pjesëmarrje masive
- Rritet bashkëpunimi strategjik Shqipëri–Izrael në fushën kibernetike

Në prag të garës evropiane të sigurisë kibernetike ECSC 2025/ Vijon përzgjedhja e ekipit shqiptar



Vijon procesi i përzgjedhjes së ekipit kombëtar që do të përfaqësojë Shqipërinë në European Cyber Security Challenge 2025. Pjesëmarrësit po testojnë aftësitë e tyre në skenarë praktikë të mbrojtjes dhe reagimit ndaj incidenteve, ndërsa procesi do të pasohet nga trajnime dhe sfida të tjera për të përcaktuar ekipin fitues.

Në tetor, 10 më të mirët do të përfaqësojnë Shqipërinë në Varshavë, në garën më prestigjioze evropiane për talentet e reja të sigurisë kibernetike. Me mbështetjen e UNDP Shqipëri dhe projektit “Youth for Inclusion, Equality, and Trust”, AKSK po i kthen aftësitë dhe pasionin e të rinjve shqiptarë në mundësi reale për sukses dhe përfaqësim ndërkombëtar.

AKSK prezanton mekanizmin e ri të raportimit javor për infrastrukturën kritike dhe të rëndësishme të informacionit

AKSK zhvilloi një takim me përfaqësues nga infrastrukturën kritike dhe të rëndësishme të informacionit, në kuadër të ligjit të ri për Sigurinë Kibernetike dhe kërkesave të Direktivës NIS2. Në fokus ishte prezantimi i mekanizmit të ri javor për raportimin e tentativave kibernetike dhe incidenteve pa impakt, i cili synon rritjen e kapaciteteve parandaluese dhe reaguese.

Drejtori i Përgjithshëm, z. Igli Tafa, theksoi se raportimi i rregullt dhe i saktë është një element kyç për mbrojtjen e infrastrukturave kombëtare dhe forcimin e sigurisë digjitale, duke konsoliduar bashkëpunimin ndërmjet AKSK-së dhe institucioneve përgjegjëse.



Adresa : Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 3, Kati I Tiranë



www.aksk.gov.al



@aksk.gov.al



+355 422 21 039



BULETIN MUJOR

GUSHT 2025



Maratona Kombëtare e Sigurisë Kibernetike: Sfida dhe pjesëmarrje masive

Që prej 1 gushtit, ka nisur Maratona Kombëtare e Sigurisë Kibernetike, një nismë gjithëpërfshirëse që angazhon studentë dhe të rinj nga 25 universitete e shkolla profesionale. Vetëm gjatë fazës së parë janë zhvilluar 87 sfida CTF dhe janë fituar 80 flamuj, duke treguar energjinë dhe talentin e pjesëmarrësve.

Në muajt në vijim, maratona do të kalojë në faza më të avancuara mbi Threat Intelligence, Defensive Security (Blue Team) dhe Offensive Security (Red Team), duke ndërtuar kapacitete reale për një të ardhme digjitale më të sigurt në Shqipëri.

Rritet bashkëpunimi strategjik Shqipëri–Izrael në fushën kibernetike

Në vijim të angazhimeve për rritjen e qëndrueshmërisë digjitale, AKSK mirëpriti një delegacion nga Izraeli në kuadër të një workshop-i të dedikuar për shkëmbimin e praktikave më të mira dhe forcimin e bashkëpunimit teknik. Drejtori i Përgjithshëm i AKSK, z. Igli Tafa, theksoi rëndësinë e partneritetit me Izraelin në ndërtimin e një sistemi të integruar dhe të qëndrueshëm të sigurisë kibernetike.

Ambasadorja e Izraelit në Shqipëri, znj. Galit Peleg, nënvizoi angazhimin e vendit të saj për të mbështetur Shqipërinë në përballjen me sfidat digjitale. Në workshop morën pjesë përfaqësues nga institucionet kryesore shqiptare, duke konfirmuar vizionin për një bashkëpunim afatgjatë dhe një hapësirë digjitale më të sigurt për qytetarët dhe institucionet.



Adresa : Rruga "Papa Gjon Pali
II", Nr. 3, Kati I Tiranë



www.aks.gov.al



@aks.gov.al



+355 422 21 039